

VLERËSIMI AGROMETEOROLOGJIK PËR PERIUdhËN 1-10.09.2004

Referuar situatës së pritëshme meteorologjike dhe fazave përfundimtare në të cilën ndodhen bimët në tërësi, rezulton se duhet përsheptuar puna në grumbullimin dhe largimin sa më të shpejtë të prodhimeve nga parcelat, për të minimizuar humbje të tij apo ulje të cilësisë, si pasojë e rreshjeve të mundëshme, të pritëshme në gjysmën e dytë të periudhës. Nga pikëpamja agrometeorologjike duhet nënvizuar fakti se nga dita në ditë sasia e rrezatimit diellor për arsye astronomike vjen në ulje, rritja e vranësirës dhe ulja graduale e temperaturës do të jenë shenjat e para të futjes në karakteristikat e stinës së vjeshtës. Normalisht, pritet një ulje dhe për treguesin e situatës për zjarre në pyje e kullota.

* * *

BIOMETEOROLOGJI: Treguesi i rrezatimit ultraviolet sipas një klasifikimi të aprovuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Organizata Botërore e Meteorologjisë paraqitet sipas shkallës me gjyra si vijon: I ULET për vlera 0,1,2; MESATAR për vlera 3,4,5; I LARTE për 6, 7; SHUME I LARTE për 8,9,10; dhe EKSTREM për vlera mbi 10. Siç shihet dhe në vijim, kërkohet marrja e masave mbrojtëse dhe një qëndrim më i kufizuar në orët e mesditës nën rrezet e diellit edhe për ditët në vijim. Vlerësimi i treguesit të rrezatimit UV për periudhën 1-5.09.2004 në rajonin ku ndodhet dhe vendi ynë, jepet nëpërmjet treguesve simbolike, paraqitur në tabelën në vijim.

Data:	1 shtator	2 shtator	3 shtator	4 shtator	5 shtator
Treguesi i Rrezatimit Ultraviolet					

* * *

i Për informacione më të fundit në lidhje me vlerësimin agrometeorologjik të situatës jeni të mirëpritur të na kontaktoni nëpërmjet numrave: Tel/Fax: (04) 223 518 (Drejtoria) & Tel: 259359 / 53 (Sektori i Agrometeorologjisë).

* * *

Fjalor Terminologjik Agrometeorologjik

Dendrohydrology (A), dendrohydrologie (F), dendroidrologia (I), dendrohidrología (S), dendrohidrologia (Sh) :

Përdorimi i unazave vjetore të rritjes së pemëve për të studiuar fenomenet hidrologjike.

* * *

Përgatitur nga Sektori i Agrometeorologjisë

Botim i Akademisë së Shkencave - Institutit Hidrometeorologjik

Tiranë, © 2004.

Abonimi vjetor: 3600 Lekë

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet pa lejen me shkrim të botuesit.



AKADEMIA E SHKENCAVE INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK Departamenti i Meteorologjisë Sektori i Agrometeorologjisë

Adresa: Rr. Durrësit, K.P.219, Tiranë.

Tel:(+ +355)4 259359/53 Fax:(+ +355)4 223518

E-mail: agrometeoalb@yahoo.com

BULETINI AGROMETEOROLOGJIK

Nr. 24

Muaji: GUSHT

Dekada: e tretë




TIRANË, 2004

Vlerat Mesatare të Treguesve Agrometeorologjikë për periudhën: 21-31 gusht 2004

Vëndmatjet	TREGUESIT AGROMETEOROLOGJIK							
	T. max abs.	T. min abs.	T. mes (°C)	Σ TA >10°C	Σ Rreshje mm	Nr.ditë Rreshje >0mm	Avullimi ditor ne mm	Ndryshimi temp. me dek.II-08
Koplik	33.0	14.4	24.2	266.0	1.2	1	4.4	-0.4
Shkodër	32.5	17.3	24.5	269.0	1.0	1	4.4	0.2
Lezhë	32.0	15.0	24.0	263.8	0.1	1	4.3	0.5
Durrës	32.2	17.0	24.2	266.5	9.0	1	4.4	-0.1
Tiranë	35.2	15.1	23.8	261.8	4.9	2	4.3	-0.1
Elbasan	36.0	14.5	25.2	277.7	9.0	1	4.5	0.7
Cërrik	36.0	13.0	23.9	263.0	10.0	2	4.3	0.2
Vlorë	37.5	13.2	23.9	255.4	0.6	1	4.2	1.2
Kukës	35.4	8.8	20.0	220.3	11.9	2	3.6	-0.4
Peshkopi	32.0	9.5	19.7	216.3	8.0	1	3.5	0.9
Pukë	30.0	11.0	20.1	221.4	1.0	1	3.6	1.0
Bulqizë	31.0	9.3	19.6	215.1	7.5	2	3.5	0.5
Pogradec	32.6	9.5	19.6	215.3	2.0	1	3.5	0.2
Korçë	31.9	9.0	19.2	211.2	4.0	1	3.5	0.1
Ersekë	31.0	6.5	18.3	201.0	0.0	0	3.3	1.0
Burrel	32.2	16.0	23.8	261.6	9.0	1	4.3	-

Situata Agrometeorologjike për periudhën 21-31.08.2004

Kjo periudhë u karakterizua me mot kryesisht të qëndrueshëm, me temp. mes. 18-25°C. Gjatë dekadës u sigurua një Σ TA >10°C: 200-280°C. U vrojtuan 1-2 ditë me rreshje të pakta në mesin e periudhës, lartësia e të cilave ishte nën normë. Në Korçë rreshjet u shoqëruan dhe me breshër. Vlerat e avullimit ditor dhe të evapotranspiracionit vijuan të ngelen të larta. Temperaturat e larta në mesdite 30-38°C favorizuan zjarret në zonat pyjore e kullota.




Kushtet agrometeorologjike të kësaj periudhe përgjithësisht ishin të favorshme për bujqësinë në tërësi. Megjithatë, sipas zonave të caktura dhe kushteve fiziko gjeografike ato patën dhe influenca të tjera si p.sh. u vrojtuan zjarre në pyje e kullota në rrethet Tepelenë e Gjirokastrë ku në mesditë temperaturat e ajrit ishin të larta; ndërkohë që rreshje në formë breshëri të vrojtuar në zonën e Korçës, natyrisht ishin jo pozitive për këtë fazë përmbyllëse të ciklit jetësor të bimëve dhe të grumbullimit të prodhimit.

* * *

Vlerat Mesatare Shumëvjeçare të Treguesve Agroklimatikë për periudhën: 1-10 shtator

Vëndmatjet	TREGUESIT AGROKLIMATIKE	
	T. mes. e ajrit në (°C)	Rreshjet në (mm)
Koplik	23.3	20.4
Shkodër	22.7	32.5
Lezhë	22.4	20.7
Durrës	22.6	13.1
Tiranë	22.3	19.0
Elbasan	21.9	17.7
Cërrik	22.4	18.4
Vlorë	22.9	14.8
Kukës	19.8	17.7
Peshkopi	19.1	14.8
Pukë	18.2	25.1
Bulqizë	17.5	21.9
Pogradec	19.0	17.0
Korçë	18.3	20.2
Himarë	22.1	23.5
Lushnjë	23.1	13.8
Fier	21.6	16.7
Berat	21.8	25.4

Amplitudat e temperaturës së ajrit shënuan një rritje kundrejt dekadës së mëparshme dhe përgjithësisht favorizuan një raport të mirë në fazat përfundimtare të ciklit të mjaft kulturave, përsa i përket raporteve frymëmarrje fotosintezë. Në grafikun në të majtë paraqiten vlerat e këtij treguesi për 16 vëndmatje, duke na dhënë një tablo më të plotë për natyrën e madhësisë së tij në pjesë të ndryshme të territorit.



Parashikimi i motit për periudhën: 1-10.09.2004

Ky 10-ditor, gjatë gjysmës së dytë të tij, shfaq mundësi për rreshje, madje ka mundësi që rreshjet të përfshijnë gjithë territorin. Kjo për arsye se nga mesi i 10-ditorit do të kalojmë gradualisht nga një qarkullim, kryesisht, anticiklonar në një qarkullim ciklonar. Temperaturat: mesatarja e periudhës pritet të jetë rreth mesatares shumëvjeçare të saj.

Sektori i Parashikimeve Meteorologjike Tel: 222439

